



REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	27 - 07 2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK5373/2023			1/8



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.844/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.844/2023 të datës 14.06.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër protokolli 08/27-650-2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.844/2023 e datës 14.06.2023, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 08/27-650-2023 i datës 16.05.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Ankuesi (tutje vetëm ankuesi) më datë 14.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.844/2023, kundër Vendimit me numër protokolli 08/27-650-2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me pretendimet ankimore se kriteret e konkursit janë ndryshuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, kandidatja e përzgjedhur nuk ka përvojën e punës së kërkuar sipas konkursit, dhe se në intervistën me gojë janë shkelur kriteret e intervistës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli) në pajtim

me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa kjo e fundit më datë 23.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së janë plotësuar kushte për pranueshmerinë të ankesës siç përcaktohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 4736/2023 të datës 14.06.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shpalljen e konkursit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për plotësimin e vendit të lirë të punës për pozitën 1.KQZ-11/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë; Shpalljen e konkursit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për plotësimin e vendit të lirë të punës për pozitën: 1. KQZ-16/2019 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Gjakovë, 2.KQZ-17/2019 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Dragash, 3. KQZ-18/2019 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Istog, KQZ-19/2019 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Klinë, 5.KQZ-20/2019 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Skenderaj, KQZ-21/2019 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Shtërpçë; Vendimin me numër protokollit 08/27-650/2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të KQZ-së; Përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 02/710/A-2023 të datës 13.06.2023 të Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së; Kërkesën për plotësim ndryshim të përshkrimit për vendin e punës për pozitën: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve me numër protokollit 60-2020 të datës 22.01.2023 të Drejtorit të Departamentit të Koordinimit në Terren të KQZ-së; Procesverbalin nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me numër protokollit 163-2020 të datës 14.02.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.06.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 06-2-763-2023 të datës 23.06.2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dërguar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për vazhdimin e afatit të konkursit për pozitën 1.KQZ-11/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë të lëshuar nga KQZ; Vendimin me numër protokollit 02-245-2023 të datës 08.03.2023 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Akt emërimit me numër protokollit 02/1268-2022 të datës 24.10.2022 të lëshuar nga KQZ për N.H; Akt emërimit me numër protokollit 685/2019 të datës 02.07.2019 të lëshuar nga KQZ për F.L; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt emërimit me numër protokollit 71-2-2019 të datës 04.02.2019 të lëshuar nga KQZ për V.K; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt emërimit me numër protokollit 67-4-2019 të datës 04.02.2019 të lëshuar nga KQZ për M.M; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt emërimit me numër protokollit 64-29-2019 të datës 04.02.2019 të lëshuar nga KQZ për Z.S; Regjistrin e Aplikacioneve të Pranuara në KQZ për pozitën KQZ-11/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë; Raportin e datës 16.03.2023 të Kryesuesit të Komisionit Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë për pozitën KQZ-11/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë; Testin me shkrim të datës 20.03.2023 për pozitën KQZ-11/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë; Vlerësimi i kandidatit M.M nga të gjithë anëtarët e Komisionit; Vlerësimi i kandidatës E.M nga të gjithë anëtarët e Komisionit; Raportin e datës 22.03.2023 të Komisionit për vlerësimin e testeve me shkrim për pozitën KQZ-11/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë; Testin me shkrim të datës 20.03.2023 të kandidatës E.M-P; Testin me shkrim të datës 20.03.2023 të kandidatit A.Z; Testin me shkrim të datës 20.03.2023 të kandidatit B.B; Testin me shkrim të datës 20.03.2023 të kandidatës B.K-R; Testin me shkrim të datës 20.03.2023 të kandidatit

B.M; Testin me shkrim të datës 20.03.2023 të kandidatit D.G; Testin me shkrim të datës 20.03.2023 të kandidatit F.L; Testin me shkrim të datës 20.03.2023 të kandidatit M.M; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 31.03.2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë; Ankesën me numër protokolli 09/542-2023 të datës 26.04.2023 të M.M drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Kopjen e Letërnjoftimit të M.M; E-mail i datës 16.05.2023 i dërguar nga V.B për M.M; Vendimin me numër protokolli 117-2020 të datës 08.02.2020 për plotësim ndryshimin e përshkrimit të detyrave, përgjegjësi dhe kualifikimeve të vendit të punës, Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve të lëshuar nga Kryetarja e KQZ-së; Përshkrimi i punës për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve; Kërkesë për punësim të E.M-P të datës 23.02.2023 në KQZ për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë; Deklaratën e E.M-P të datës 23.02.2023; Kopjen e Letërnjoftimit të E.M-P; Aplikacioni i kandidates E.M-P së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Certifikatën mbi dënimet penale të E.M-P të datës 23.01.2023 të lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës; Kontratën me numër protokolli 04-052-73 të datës 03.03.2021 në mes Ministrisë së Financave- Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe E.M; Marrëveshjen për shërbimet e veçanta të datës 26.10.2020 në mes KQZ-së dhe E-M; Vërtetimin e Sekretariatit të KQZ-së për E.M të datës 31.12.2017; Vërtetimin e Sekretariatit të KQZ-së për E.M të datës 26.09.2014; Vërtetimin e SH.M.P Qendra e Kompetencës për E.M të datës 21.05.2018; Kontratën e lidhur në mes

in dhe E.M; Letër rekomandimin e datës 28.12.2017 të Udhëheqësit të Divizionit për Buxhet dhe Financa të KQZ-së për E.M; Letër rekomandimin e datës 14.02.2020 të Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme të KQZ-së për E.M; Vërtetimin e datës 13.12.2018 të N.T.P " Edorrita" për E.M; Referencën me numër protokolli 3009 të datës 29.08.2012 të Inspektoratit të Infrastrukturës Rrugore për E.M; Certifikatën e datës 15.12.2018 të lëshuar nga Akademia Profesionale Elita për E.M; Certifikatën e datës 23.06.2018 të lëshuar nga Akademia Profesionale Elita për E.M; Certifikatën e datës 21.06.2018 të lëshuar nga "IMB" për E.M; Certifikatën e datës 10-21.12.2018 të lëshuar nga "IMD" për E.M; Certifikatën e muajit Tetor 2013 të lëshuar nga Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve për E.M; Certifikatën e vitit 2017 të lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për E.M; Certifikatë e lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave për E.M; Certifikatë e lëshuar nga " BSC Kosovo" për E.M; Certifikatë me numër 552 të datës 06.01.2011 e lëshuar nga "ZAS Trade" për E.M; Certifikatë me numër 760 e lëshuar nga " ZAS Trade" për E.M; Marrëveshjen për shërbime të veçanta në mes KQZ-së dhe E.M të datës 11.01.2021; Vërtetimin për pranimin e aplikacionit me numër 02/2023 të datës 23.02.2023 në Divizionin e Personelit -SKQZ; Diplomën me numër 2423 të datës 05.07.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik për E.M; Diplomën me numër 424 të datës 18.11.2013 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakultetit Ekonomik për E.M; Kërkesë për punësim të M.M të datës 08.03.2023 në KQZ për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë; Kopjen e Letërnjoftimit të M.M; Vërtetimin e datës me numër protokolli 882/4 të 08.03.2023 të lëshuar nga Qendra e Kompetencës

Malishevë për M.M; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 07.03.2023 të lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës për M.M; Letrën motivuese të datës 08.03.2023 të M.M; Referencën me numër protokolli 470/3 të datës 29.10.2018 të lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për M.M; Letrën Rekomanduese të datës 31.10.2018 të Qendrës për Kompetencë në Malishevë për M.M; Vlerësimin e performances së mësimdhënësve me numër protokolli 477/3 të datës 29.10.2018 të Drejtorit të Qendrës së Kompetencës

për M.M; Vlerësimin e performances së mësimdhënësve të datës 29.10.2018

të Drejtorit të Qendrës së Kompetencës për M.M; Vendimin me numër protokolli 342/2012 të datës 23.10.2012 të Qendrës së Kompetencës në Malishevë; Vërtetimin për punën praktike në shërbimin civil me numër protokolli 03/319 të datës 08.03.2012 të lëshuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës për M.M; Certifikatën e datës 28.04.2017 të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për M.M; Certifikatën me numër 8559/003 të lëshuar nga MASHT dhe SBASHK për M.M; Certifikatën me numër 8248/002 të lëshuar nga MASHT dhe SBASHK për M.M; Certifikatën e muajit Nëntor dhe Dhjetor 2019 të lëshuar nga KDI; Certifikatën e datës 04.04.2019 të lëshuar nga KDI për M.M; Certifikatën e lëshuar nga ISEPS dhe Kolegji Universum për M.M; Certifikatën e muajit Qershor 2020 të lëshuar nga QAPA dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për M.M; Certifikatën e datës 08.09.2014 të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe M.M; Certifikatën e muajit Dhjetor 2009 të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për M.M; Certifikatë me numër 1/17 të lëshuar nga Certifikatën me numër 1/16 të lëshuar nga Certifikatën me numër protokolli 175/09 të datës 07.07.2009 të lëshuar nga "The Neë York School" për M.M; Certifikatën 01M-0280-04 të datës 20.06.2004 të lëshuar nga FONDA KOS dhe Sektori i Kulturës për M.M; Mirënjohjen e datës 07.03.2012 të lëshuar nga Drejtoria për Arsim dhe Edukim në Malishevë për M.M; Mirënjohjen e datës 03.12.2018 të lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për M.M; Mirënjohjen e datës 21.06.2018 të lëshuar Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për M.M; Mirënjohjen e datës 01.12.2017 të lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për M.M; Pasqyra e llogarisë së Trustit për periudhën 01.08.2022-10.03.2023 të M.M; Vërtetimin për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit-SKQZ me numër 11/2023 të datës 08.03.2023 të M.M; Diplomën me numër 80 të datës 18.02.2010 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik për M.M; Diplomën më numër 464 të datës 04.02.2009 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik për M.M; E-mailin e datës 23.03.2023 i dërguar nga V.B për "daki008"; E-mailin e datës 23.03.2023 i dërguar nga V.B për A.Z; E-mailin e datës 23.03.2023 i dërguar nga V.B për "besmori"; E-mailin e datës 23.03.2023 të dërguar nga V.B për B.B; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për V.B; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për D.P; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për A.G; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për G.K; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për E.M; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për "daki008"; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për B.K; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për F.L; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për A.Z; E-mailin e datës 23.03.2023 të dërguar nga V.B për E-mailin e datës 23.03.2023 të dërguar nga V.B për E.M; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për B.B; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për A.K; E-mailin e datës 17.03.2023 të dërguar nga V.B për M.M; E-mailin e datës 31.03.2023 të dërguar nga V.B për E.M; E-mailin e datës 14.03.2023 të dërguar nga N.H për M.M, F.L, V.K dhe Z.S; E-mailin e datës 31.03.2023 të dërguar nga V.B për M.M; E-mailin e datës 31.03.2023 të dërguar nga V.B për F.L; E-mailin e datës 31.03.2023 të dërguar nga V.B për B.K; E-mailin e datës 23.03.2023 të dërguar nga V.B për B.K; E-mailin e datës 23.03.2023 të dërguar nga V.B për F.L; E-mailin e datës 23.03.2023 të dërguar nga V.B për M.M; E-mailin e datës 23.03.2023 të dërguar nga V.B për "daki008".

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se pretendimet ankimore të ankuesit janë të **pabazuara, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (me tej SKQZ) më datë 13.02.2023 ka publikuar Konkursin me numër KQZ-11/2023 për pozitën *Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë*, niveli profesional-G 6/13.5, me afat të aplikimit nga data 13.02.2023 deri 28.02.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesi i cili sipas shkresave të lëndës është përfshirë në listën e ngushtë së bashku me tetë (8) kandidatë të tjerë.

Tutje nga shkresat e lëndës rezulton se me datën 22.03.2023 Komisioni Përzgjedhës i themeluar sipas Vendimit Nr.02-245-2023 të datës 08.03.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së, ka hartuar raportin mbi vlerësimin e testeve me shkrim sipas të cilit del se nga nëntë (9) kandidatët vetëm tetë (8) ju kanë nënshtruar testit me shkrim, prej tyre katër (4) nga kandidatët përfshirë edhe ankuesin kanë kaluar fazën e testimit me shkrim, njëherazi duke propozuar që mbajtja e intervistës me gojë të realizohet më datën 24.03.2023. Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit me gojë, Njësia e Burimeve Njerëzore të SKQZ-së më datë 31.03.2023 ka njoftuar ankuesin se i njëjti ka rritur gjithsejtë 71.1 pikë të vlerësimit, rrjedhimisht sipas emailit të datës 31.03.2023 të Burimeve Njerëzore kandidatja është vlerësuar si kandidatja me më së shumti pikë gjithsejtë 86.5 pikë duke u shpallur edhe si kandidatja e përzgjedhur për pozitën *Zyrtar i lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë*.

Ankuesi i pakënaqur me mos përzgjedhjen, më datë 26.04.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKQZ-së, ndërsa ky i fundit më Vendimin me numër protokolli 08/27-650-2023 të datës 16.05.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 31.03.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se kriteret e konkursit janë ndryshuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ngase në vitin 2019 për të njëjtën pozitë janë paraparë kriteret profesionale Drejtësi, Shkenca politike dhe Administratë Publike, ndërsa në konkursin e fundit janë përfshirë si kriteret profesionale edhe fusha e ekonomisë dhe të tjera, pretendon se kandidatja e përzgjedhur nuk ka përvojën e punës së kërkuar dhe po ashtu në intervistë me gojë janë shkelur kriteret e intervistës për shkak se anëtarët e Komisionit të Pranimit nuk kanë parashtruar pyetje që ndërlidhen me aftësitë komunikuese, sjellën nën presion, aftësitë të shpjeta analitike, si dhe vizionin dhe potencialin për të ardhmen.

Referuar konkursit me numër KQZ-11/2023 për pozitën *Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë*, si kushte lidhur me kualifikimin, aftësitë dhe përvojën e punës janë përcaktuar: 1. *Të ketë diplomë universiteti në lëmin e drejtësisë, ekonomisë, administratës publike, shkencave politike, të drejtave të njeriut, administrim të zgjedhjeve, shkenca sociale, marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhment ose statistikë; dhe 2. Së paku katër (4) vite përvojë pune.*

Bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, dhe monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese, përfshirë këtu edhe personelin e Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë funksionale dhe organizative të tyre (*shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO171/18 të datës 20 maj 2019,*

paragrafi 144 dhe 146). Për më tepër Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shqyrton dhe vendos ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil edhe në Sekretariatën e Komisionit Qendror Zgjedhor, mirëpo respekton pavarësinë funksionale dhe organizative duke respektuar aktet e tyre të brendshme lidhur me rregullimin e procedurave të rekrutimit, kështu që në mënyrë specifike Kolegji në trajtimin e kësaj çështje juridiko-administrative iu referua Ligjit Nr.03/L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, dhe Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuere të Nëpunësve në Sekretariatën e Komisionit Qendror Zgjedhor, Rregullores Nr. 02/2017 – Përshkrimi i Detyrave të Punës dhe Klasifikimi i Vendeve të Punës në SKQZ; Rregullores Nr. 01/2017 – Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i Vendeve të Punës në SKQ si dhe Udhëzimin Administrativ (KQZ) Nr.02/2018 për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Lidhur me pretendimin ankimor se kriteret e konkursit janë ndryshuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ngase në vitin 2019 për të njëjtën pozitë janë paraparë kriteret profesionale Drejtësi, Shkenca Politike dhe Administratë Publike, ndërsa në konkursin e fundit janë përfshirë si kriteret profesionale edhe fusha e Ekonomisë dhe të tjera, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucion i pavarur kushtetues dhe siç u konstatua më lartë çështjet e rregullimit përkritazi me klasifikimin, sistematizimin dhe përshkrimin e detyrave të punës janë të rregulluara me akte të brendshme juridike si Rregulloren Nr. 01/2017 – Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i Vendeve të Punës në SKQZ dhe Rregulloren Nr.02/2017 për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku sipas nenit 9 paragrafit 1 të Rregullores Nr.02/2017 për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është përcaktuar se: *“Me aprovimin e KQZ-së, përmes Kryeshefit Ekzekutiv, një përshkrim i punës mund të ndryshohet dhe plotësohet në rast të: 1.4. ndryshimit të kushteve të punës”*. Nga ky konstatim si dhe bazuar në provat materiale rezulton se Komisionit Qendror i Zgjedhjeve më datë 07.02.2020 ka mbajtur mbledhjen e tij, ku ndër pikat e rendit të ditës ka qenë *“shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit ndryshimit për përshkrimin e vendit të punës për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve”*, si rezultat i kësaj anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me 10 vota për dhe një votë abstenim kanë miratuar ndryshim-plotësimin për përshkrimin e vendit të punës për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve, si rrjedhojë më datë 08.02.2020 është nxjerr Vendimi me numër protokollit 117-2020 si dhe përshkrimi i ri i detyrave të punës për këtë pozitë të punës, për të cilën janë paraparë kualifikimet, aftësitë dhe përvoja e punës të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e punës e përcaktuar me konkursin me numër KQZ-11/2023. Për më shumë ankuesi nuk mund të tërheq paralele me konkurset paraprake të shpallura për pozitë të njëjtë, sepse për konkurset paraprake të njëjtat janë shpallur në pajtim me kriteret që kanë qenë në fuqi në atë kohë, ndërsa me rastin e shpalljes së Konkursit me numër KQZ-11/2023 kemi kriteret tjera të pranimit për pozitën në fjalë, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk ka mbështetje ligjore.

Nuk qëndron pretendimi ankimor së Komisioni nuk ka respektuar kriterin e përvojës së punës respektivisht se kandidatja e përzgjedhur nuk ka përvojën e punës së kërkuar sipas konkursit, ngase sipas ankuesit Vërtetimi i lëshuar nga është fiktiv, Kolegji bazuar në vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit ka gjetur së kandidatja e përzgjedhur Paçarizi posedon Diplomën me Nr. 2423 të datës 05.07.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, përmes të cilës dëshmohet se më datë 20.10.2011 ka mbaruar studimet në Fakultetin Ekonomik në

Departamentin për Menaxhment dhe Informatës duke marrë titullin Baçelor për Menaxhment dhe Informatikë, kurse ndërlidhur me përvojën e punës e njëjta sipas Referencës së datës 28.08.2012 ka ndjekur praktikën në Ministrinë e Infrastrukturës nga data 21.06.2012 deri më datë 20.07.2012 (1 muaj), sipas Certifikatës të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave ka kryer praktikën në Departamentin e Buxhetit Komunal për periudhën nga data 13.08.2012 deri më datë 31.08.2012 (18 ditë); sipas Vërtetimit të datës 26.09.2014 ka punuar në SKQZ nga data 22.08.2013 deri më datë 31.12.2013 dhe nga data 12.05.2014 deri më datë 15.08.2014 në pozitën Zyrtare Financiare (7 muaj e 12 ditë), sipas Vërtetimit të datës 31.12.2017 ka punuar SKQZ në pozitën Zyrtare e Financës nga data 13.05.2017 deri më datë 31.12.2017 (7 muaj e 19 ditë), sipas Vërtetimit me Nr.99/3 të lëshuar nga SH.M.P Qendra e Kompetencës ka punuar si mësimdhënëse nga data 09.02.2018 deri më datë 02.05.2018 (2 muaj e 23 ditë), sipas Letër rekomandimit të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka përfunduar praktikën nga data 05.09.2019 deri më datës 15.02.2020 (5 muaj e 10 ditë), sipas Marrëveshjes për shërbime të veçanta e njëjta nga data 26.10.2020 deri më datës 25.11.2020 ka punuar në KQZ në pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa (1 muaj), sipas Kontratës së Punës së datës 03.03.2021 të lidhur me Agjencinë e Statistikave të Kosovës e njëjta ka qenë në marrëdhënie punë nga data 03.03.2021 deri më datë 28.02.2023 në pozitën Konsulent (2 vite). Andaj, nisur nga këto dëshmi rezulton se kandidatja e përzgjedhur edhe pa përvojën e punës në ka plotësuar kriterin e përvojës lidhur më pozitën e shpallur dhe rrjedhimisht, Kolegji konstaton se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 21 të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku përcaktohet se: *Anëtarët e Komisionit Përzgjedhës vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim: 1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional i dokumentuar, që konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit të kandidateve dhe dëshmitë e ofruara për shkollim dhe kualifikime dhe përvojën, vlerësimin e arsimimit dhe vlerësimin e trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse të përgjegjësisë. 1.2 Përvoja e punës, që konsiston në eksperiencën përkatëse profesionale dhe menaxheriale, varësisht nga pozita e klasifikuar e punës”* si dhe nenin 31 të kësaj rregullore më të cilin përshihet: *Kushtet e kërkuara për emërim 1. Në Sekretariat emërohen kandidatet, të cilët kanë arritur numrin me të madh në total të pikëve në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë. 12 2. Pikët e përgjithshme në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë mbledhen dhe pjesëtohen për dy). 3. Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe intervistën me gojë) është vlerësuar me numrin me të madhë të pikëve, jo me pakë se 60% të pikëve në total.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni Përzgjedhës ka shkalur nenin 29 pikën 1.2 të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ngase në intervistën me gojë anëtarët e komisionit nuk kanë parashtruar pyetje që ndërlidhen me aftësitë komunikuese, sjellën nën presion, aftësitë të shpejta analitike, si dhe vizionin dhe potencialin për të ardhmen, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës nuk ka arritur të argumentoj këtë pretendim ankimor të ankuesit.

Në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji ka analizuar ligjshmërinë e veprimeve procedurale që përbejnë tërësinë e procesit të rekrutimit sipas Konkursit Nr. KQZ-11/2023 për pozitën “Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë” të shpallur nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe si rrjedhojë nuk është konstatuar ndonjë shkelje procedurale dhe materiale të cilat në esencë do ta bënin si të paligjshme këtë procedurë të pranimit, andaj mbi bazën e këtij konstatimi Kolegji vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit


Qendror të Zgjedhjeve me rastin e nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar me ankesë gjegjësisht Vendimit më numër protokolli 08/27-650-2023 të datës 16.05.2023 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike duke vepruar në pajtim me ligjin material përkatësisht Rregulloren Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatën e Komisionit Qendror Zgjedhor, Rregulloren Nr.02/2017 - Përshkrimi i Detyrave të Punës dhe Klasifikimi i Vendeve të Punës në SKQZ si dhe Udhëzimin Administrativ (KQZ) Nr.02/2018 për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.844/2023.

Ardita Perçuku-Shyti



Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKQZ dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.